



Pranimar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	02.02	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM&HCK	501/2022		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.15/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1426/20 të datës 11.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.168/2020 të datës 22.06.2020 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me Nr.03/02-130/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.168/2020 e datës 22.06.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.03/02-130/20 i datës 06.04.2020 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 22.06.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1206/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.03/02-130/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, të cilin e ka pranuar më datë 18.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 25.06.2020, ankesën e

ankueses e ka proceduar për përgjigje tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës me datë 15.07.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2020 përmes Njoftimit me Nr. Prot:1541/2020, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.168/2020 të datës 22.06.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 11.01.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1426/20, i cili në KPMSHCK është pranuar me datë 13.01.2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 13.08.2020 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr.168/2020 të datës 22.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot: 1206/2020 të datës 22.06.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër prot.Nr.03/02-130/20 të datës të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; Vendimin me numër prot.Nr.03/02-38 të datës 28.01.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; Konkursin në Policinë e Kosovës me numër të referencës 07/1-01R/06/19; Konkursin në Policinë e Kosovës me numër të referencës 07/1-01R/04/17; Konkursin në Policinë e Kosovës me numër të referencës 07/1-01R/02/18; Ankesën e ankueses të datës 23.12.2019 për Komisionin për Ankesa në Policinë e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 21.02.2020; Ankesën e ankueses të datës 06.03.2020 për Komisionin për Ankesa në Policinë e Kosovës; Vendimin për sistemim i datës 03.12.2019 me numër të referencës 07/1-01SAP-P/10547; E-mailin zyrtar të datës 01.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 11.06.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.06.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.07.2020 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e punës së ankueses me numër të referencës 07/1-01A/0096; E-mailin zyrtar të datës 05.12.2018; Kartelën e nëpunësit për periudhën janar 2019-dhjetor 2020 e datës 06.07.2020; E-mailin zyrtar të datës 13.01.2020; E-mailin zyrtar të datës 21.02.2020; E-mailin zyrtar të datës 13.02.2020 dhe E-mailin zyrtar të datës 05.12.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në provat e lëndës ankuesja është e punësuar në bazë të Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 16.07.2013 në pozitën "Përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas" në Policinë e Kosovës, ndërsa në bazë të Vendimit me Nr. Reference 07/1-01SAP-P/10547 të datës 03.12.2019 ankuesja është sistemuar në kohë të pacaktuar në të njëjtën pozitë me pagë 423.85 Euro dhe 25 Euro shtesë.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr. Reference 07/1-01SAP-P/10547 të datës 03.12.2019, duke kërkuar harmonizim të koeficientit me nëpunësit e tjerë në institucionet e nivelit qendror, me datë 23.12.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës për kompensim të diferencës së koeficientit për tri vite në mënyrë retroaktive.

Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me datën 28.01.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr. 03/02-38 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Drejtorinë e Personelit.

Drejtoria e Personelit me datën 21.02.2020, ka njoftuar ankuesen se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovoj koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civilë, duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesja kundër njoftimit të datës 21.02.2020 të Drejtorisë së Personelit, me datën 09.03.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës lidhur me mos rregullimin e koeficientit. Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës me datën 06.04.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr. Nr.03/02-130/20 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vendimi i kundërshtuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me vendimet e më hershme të këtij Komisioni i cili për këtë çështje të njëjtë ka vendosur ndryshe duke ju referuar Vendimit me Nr. 03/02-37 të datës 28.01.2020, kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, duke i njohur të drejtën e kompensimit në mënyrë retroaktive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *"1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës"*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja sipas Vendimit me Nr. Reference 07/1-01SAP-P/10547 të datës 03.12.2019 është sistemuar në kohë të pacaktuar në të njëjtën pozitë të njëjtë ashtu siç ka qenë e emëruar me Kontratën e Punës të datës 16.07.2013 dhe e njëjta realizon pagën në vlerën e përcaktuar me vendimin për sistemimin e saj të përcaktuar me aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit për harmonizim të koeficientit, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor për anulimin e Vendimit me numër protokolli me Nr.03/02-130/20 i datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, si dhe kompensimi i diferencës së pagës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, duke ju referuar dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, lidhur me ngritjen e koeficientit të pagës për disa pozita të



punës duke përfshirë edhe pozitën e ankueses, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit.

Bazuar si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll Nr.03/02-130/20 të datës 06.04.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.15/2022

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Z. *në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.